



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.112/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “NAS Systems” Sh.p.k - Gjilan kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: D.P.T “Pro-Computers”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr.prokurimit: 651-19-7027-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjilan më datë: 03.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NAS Systems” Sh.p.k - Gjilan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr.prokurimit: 651-19-7027-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjilan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr.prokurimit: 651-19-7027-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjilan, dhe lënda kthehet ne rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “NAS Systems” Sh.p.k - Gjilan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues: “NAS Systems” Sh.p.k - Gjilan si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 18.02.2020, me nr 112/20, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr.prokurimit: 651-19-7027-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, KK Gjilan duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 28 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.02.2020, ka autorizuar ekspertin teknik të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti teknik i prokurimit ,në raportin e dt: 24.02.2020 sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 1. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar deklaratë për specifikacionet teknike ashtu siç është kërkuar ne FTD.

Në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), është kërkuar, Specifikacionet teknike të detyrueshme, “3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;”. Në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk është dorëzuar deklarata për specifikimet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me mallrat e përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, rrjedhimisht OE nuk ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Sipas sqarimit të dhënë mësipërm pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 2. OE ankues pretendon se OE është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar listën e kontratave duke plotësuar Aneksin 6 të dosjes se tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë AK ka specifikuar kërkesën Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata te ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Dhe për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar nga OE që të prezantojnë “Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.”

Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë prezantuar dy referenca dhe një kontratë.

1. Kontrata e lidhur në mes të Fluidi dhe OE DPT Pro Computers me seli në Gjilan. Në lidhje me këtë kontratë OE po ashtu ka prezantuar referencën e lëshuar lidhur me zbatimin e kontratës të lëshuar nga Fluidi me datë 05.11.2019.

2.Referenca e lëshuar nga Komuna e Gjilanit, përkatësisht Zyra e Prokurimit që mban datën 25.10.2019.

Andaj bazuar në RRUOPP, Neni 39.8, ku përshkruhet se nëse Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata), AK mundë të kërkojë informata sqaruese, konsiderojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 3 OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar specifikacionin teknik për mallrat e ofertuar. Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë AK ka specifikuar kërkesën “Kërkesa 3. OE duhet të dorëzojë katalogë apo broshura për produktet e ofertuar.” Dhe për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar nga OE që të prezantojnë “Dëshmia 3. Katalogu ose broshura.”

Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë prezantuar tre katalogje, përderisa sipas dosjes së tenderit dhe formularit të çmimeve, janë 11 pajisje dhe një softuer (gjithsej 12 furnizime) për të cilat OE i rekomanduar për kontratë është dashur të prezantojë katalogë apo broshura. Rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar katalogë apo broshurë për pozicionet: 3 Sensor për matjen e gjatësisë, 4 Drita të Trafikut, 5 Serveri qendror të sistemit, 6 Terminali i Pagesës, 8 Softuer për informimin e pasagjerëve, 9 Led Displaj për perona, 11 UPS. Andaj, pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 4. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar autorizimet për terminale dhe TV sikurse është kërkuar në

dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 7 “OE duhet të ketë Autorizim nga prodhuesi për Terminalet dhe monitorët.” Si dëshmi dokumentarë për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar Kopjen e autorizimit. Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë prezantuar dy autorizime:

- a. Autorizimi i lëshuar nga Samsung Electronics Austria GmbH Zagreb Branch Office, ku theksohet se Pro Computers nga Gjilani, autorizohet përmes INFO COM si distributor për Kosovë.
- b. Autorizimi tjetër është lëshuar nga VDS AUTOMATION. Në përshkrimin e autorizimit shënohet se kompania VDS AUTOMATION është një kompani italiane që prodhon Sisteme automatike për portat -dyer Garazhi - barriera (laura) - dyert rrëshqitëse-grila-rrëshqitëse, etj.Megjithatë edhe në kërkimin në internet në faqen zyrtare të kompanisë VDS, nuk ka informacion që kompania prodhon apo ka në dispozicion terminale me elementet sikurse është kërkuar nga AK.

Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm pasi që autorizimi i prezantuar nga kompania VDS nuk përmbush kërkesën e AK-së.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 5. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që ka dorëzuar vetëm kopjen e certifikatës ISO 9001 si dhe vë në pikëpyetje origjinalitetin e certifikatës për shkak të datës.

AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 8-“OE duhet të jete i certifikuar me ISO 9001” dhe si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesës është kërkuar certifikata duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali.

Në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar certifikata origjinale ISO 9001, me numër W-20013-Q. Certifikata ka përmbajtje në gjuhën shqipe dhe angleze, mban datën e lëshimit 10.01.2020 dhe ka dy data të mbarimit: “*Data e Mbarimit të Cert. Periudhë*” ku është shënuar data 09.01.2023 si dhe “*Data e Mbarimit të Cert.*” ku është shënuar data 09.01.2021. Në fund të certifikatës është shënuar se vlefshmëria e kësaj certifikatë mund të vërtetohet përmes faqes zyrtare www.wqrcert.com ose www.thewas.us . Në verifikimin e të dhënave bazua në numrin e certifikatës në ueb faqen www.wqrcert.com, konfirmohen të dhënat dhe origjinaliteti certifikatës. Andaj pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 6 . OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që pajisja e ofertuar për pozicionin TV outdoor modeli LH460MDPWBC/EN, nuk përmbush specifikimet teknike sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit në disa elemente sikurse janë:

Vandal proof grade structure (IK08), Environment rating IP 55, Backlight Life cycle 50.000 hours, Operating temperature -30 / + 45°C, Antiglare safety 4+3 tempered glass, Shoch sensor .

Në tenderit e dorëzuar, sipas listës së pajisjeve, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me produktin Samsung, modeli me shifrën H460MDPWBC/EN. Katalogu nuk ofron informacione për plotësimin e këtyre kërkesave të përmendura në pretendim, e po ashtu nuk gjenden as në ueb faqen zyrtare në internet <https://www.samsung.com/uk/business/smart-signage/outdoor-omd-w-series/lh46omdpwbcen/>. Përderisa në lidhje me kërkesën për operim në temperaturë ku është kërkuar që të jetë minimum -30°C dhe maksimum 45 °C, ky produkt nuk e plotëson pasi që sipas katalogut edhe ueb faqes pajisja operon duke fillu nga temperatura minimale 0°C. Rrjedhimisht nuk plotësohen kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit. Andaj pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 7 . OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofertuar fare terminal hyrës dhe dalës por vetëm laure automatike dhe se prodhuesi VDS, me pajisjet e të cilit ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, nuk prodhon terminale.

AK në njoftimin në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka specifikuar kërkesat për pozicionet 1 dhe 2, përkatësisht terminal hyrës dhe dalës. Po ashtu AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën 3- “OE duhet te dorëzoj katalogë apo broshura për produktet e ofertuar”. Si dhe dëshminë dokumentare 3 “Katalogu ose broshura.”. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun për terminale. Në këtë katalog prezantohet produkti “Berta” i prodhuesit VDS. Në katalog është përshkruar barriera-laura. Mirëpo në katalog nuk ka informacione se ky produkt ka funksionet tjera të terminalit sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit nga AK. Pë shembull nuk ka informacion për kërkesat: thermal bar-code printer equipped with presenter and cutter for tickets;, alpha numeric display with 4 rows of 20 characters;, contactless smart card reader for season users;, vandal resistant taster for initiation of bar-code ticket printing;, IP intercom; modular microprocessor controller. Në RRUOPP, Neni 39.8, precizohet se në rastet kur është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara, duhet refuzuar tenderi. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i qëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR – 8 . OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofertuar Sensor për matjen e gjatësisë.

AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën 5 – “OE duhet te dorëzoj një liste te pajisjeve duke nënvizuar modelet e ofertuar.” Dhe për këtë kërkesë ka kërkuar dëshminë dokumentare – “Lista e pajisjeve duhet të jetë origjinal”.

Në listën e prezantuar të pajisjeve nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka të dhëna për pozicionin 3-Sensor për matjen e gjatësisë, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit teknik: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE - "NAS SYSTEMS" SH.P.K, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe propozohet që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim, konform dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.02.2020, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit teknik.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.02.2020, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit teknik.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 03.03.2020, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankues, përfaqësuesit e AK-së si dhe eksperti teknik, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues: z. Salihu deklaroj: Ne fillimisht jemi pajtuar me mendimin e Eksperti Shqyrtues përveç pretendimeve ankimore nr 5, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Certifikatë i ISO Original ose të noterizuar nga Originali, ne kemi ofruar ashtu siç është kërkuar, ndërsa OE i rekomanduar nuk ka ofruar Certifikate original apo të noterizuar, ajo ka ofruar vetëm të skanuar me ngjyra. Mendojmë që edhe kjo është dashtë të merret e qëndrueshme.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së ankues: z. Bajrami deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues pasi që është i pa bazuar dhe pretendimet ankimore të OE ankues janë të pa qëndrueshme. Lidhur me spec.teknik ku Eksperti i ka aprovuar nuk qëndrojnë pasi në DT janë kërkuar që të jenë sipas paramases. OE ofertues ju ka kërkuar deklarate që sipas spec.teknik të shpallur nga Autoriteti Kontraktues të ofrojnë gjatë realizimit dhe lista ashtu siç është kërkuar OE i rekomanduar ka

pasur dhe nëse merren tek televizionet dhe USB-se ato sipas Autorizimeve që ka ofruar OE i rekomanduar ato janë sipas njësisë kërkuese sipas deklaratës dhe është i obliguar ti realizoj. Sipas spec.teknik te tij dhe OE-ve te tjerë janë kërkuar forma dhe modele te cilat do te implementohen ne kuadër te saj ethe kërkuar edhe deklarate që do te përmbushët me te njëjtin specifikacion që gjatë realizimit te kontratës do ta kërkoj menaxheri i kontratës, OE ka qenë me i lire 18.000.00 euro. Sa i përket Certifikatës Iso është e verifikuar përmes linkut dhe është ne përputhje me projektin ndërsa OE-te tjerë që kanë ofertuar janë Iso për ndërtimtari. Autoriteti Kontraktues e ka ruajt paranë publike dhe ka vepruar konform DT-së sepse OE është i obligueshme ligjërisht që projektin ta realizoj sipas Spec.teknike.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti teknik z. Spahiu deklaroj: Mbesim pranë raportit të ekspertizës, i jemi përgjigjur të gjitha pretendimeve ankimore, prej 8 pretendimeve, 5 janë të qëndrueshme, 2 pjesërisht dhe një pretendim është i paqëndrueshëm. Andaj kemi rekomanduar që të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Në i kemi dhënë përgjigje ne 8 pretendime ankimore 5 nga to janë plotësisht i qëndrueshëm një është i pa qëndrueshëm dhe dy janë pjesërisht. Në lidhje me ISO që e përmendi AK ne seance nuk i kam dhen te drejtë pretendimit për shkak se konsideroj është ngarkuar Origjinali ashtu siç e ka thënë AK edhe unë e kam dhënë. Ne lidhje me TV Ofertuesi ka ofertua me një model te prodhuesit SAMSUNG që ka dorëzuar Katalogun dhe nuk i përmbush specifikat teknike sipas DT-së. Gjithashtu tek deklarata e specifikacionev ne DT te ofertuar nga Fituesi nuk ka deklaratë specifike ne 15 dokument. Ka liste pajisjeve që nuk është i plote, Qëndroj mbrapa ekspertizës se dhënë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Salihu deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovon ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Bajrami deklaroj: Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues te hedhe poshtë ankesën e OE ankuese si te pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i

rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar deklaratë për specifikacionet teknike ashtu siç është kërkuar në FTD. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), është kërkuar: Specifikacionet teknike të detyrueshme, “3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit”. Ndërsa në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk është dorëzuar deklarata për specifikimet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me mallrat e përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, rrjedhimisht OE nuk ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar listën e kontratave duke plotësuar Aneksin 6 të dosjes së tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë AK ka specifikuar kërkesën Kërkesa 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata te ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë. Dhe për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar nga OE që të prezantojnë “Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.” Ndërsa në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë prezantuar dy referenca dhe një kontratë.

1. Kontrata e lidhur në mes të Fluidi dhe OE DPT Pro Computers me seli në Gjilan. Në lidhje me këtë kontratë OE po ashtu ka prezantuar referencën e lëshuar lidhur me zbatimin e kontratës të lëshuar nga Fluidi me datë 05.11.2019 dhe 2.Referenca e lëshuar nga Komuna e Gjilanit, përkatësisht Zyra e Prokurimit që mban datën 25.10.2019. Gjithashtu Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se bazuar në RRUOPP, Neni 39.8, ku përshkruhet se nëse Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata), AK mundë të kërkojë informata sqaruese. Andaj, pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar

specifikacionin teknik për mallrat e ofertuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë AK ka specifikuar kërkesën “Kërkesa 3. OE duhet te dorëzoj katalogë apo broshura për produktet e ofertuar.” Dhe për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar nga OE që të prezantojnë “Dëshmia 3. Katalogu ose broshura.”

Ndërsa në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë prezantuar tre katalogje, përderisa sipas dosjes së tenderit dhe formularit të çmimeve, janë 11 pajisje dhe një softuer (gjithsej 12 furnizime) për të cilat OE i rekomanduar për kontratë është dashur të prezantojë katalogë apo broshura. Rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar katalogë apo broshurë për pozicionet: 3 Sensor për matjen e gjatësisë, 4 Drita të Trafikut, 5 Serveri qendror të sistemit, 6 Terminali i Pagesës, 8 Softuer për informimin e pasagjerëve dhe 9 Led Displaj për perona, 11 UPS. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar autorizimet për terminale dhe TV sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë AK ka specifikuar kërkesën numër 7 “OE duhet të ketë Autorizim nga prodhuesi për Terminalet dhe monitorët.” Si dëshmi dokumentarë për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar Kopjen e autorizimit. Ndërsa në tenderin e dorëzuar nga OE janë prezantuar dy autorizime.

- c. Autorizimi i lëshuar nga Samsung Electronics Austria GmbH Zagreb Branch Office, ku theksohet se Pro Computers nga Gjilani, autorizohet përmes INFO COM si distributor për Kosovë, dhe
- d. Autorizimi tjetër është lëshuar nga VDS AUTOMATION. Në përshkrimin e autorizimit shënohet se kompania VDS AUTOMATION është një kompani italiane që prodhon Sisteme automatike për portat -dyer Garazhi - barriera (laura) - dyert rrëshqitëse-grila-rrëshqitëse, etj.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në kërkimin në internet në faqen zyrtare të kompanisë VDS, nuk ka informacion që kompania prodhon apo ka në dispozicion terminale me elementet sikurse është kërkuar nga AK. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar pasi që autorizimi i prezantuar nga kompania VDS nuk përmbush kërkesën e AK-së.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që ka dorëzuar vetëm kopjen e certifikatës ISO 9001 si dhe vë në pikëpyetje origjinalitetin e certifikatës për shkak të datës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 8 “OE duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001” dhe si dëshmi

dokumentare për përmbushjen e kërkesës është kërkuar certifikata duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali. Ndërsa në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar certifikata origjinale ISO 9001, me numër W-20013-Q. Certifikata ka përmbajtje në gjuhën shqipe dhe angleze, mban datën e lëshimit 10.01.2020 dhe ka dy data të mbarimit: “Data e Mbarimit të Cert. Periudhë” ku është shënuar data 09.01.2023 si dhe “Data e Mbarimit të Cert.” ku është shënuar data 09.01.2021. Në fund të certifikatës është shënuar se vlefshmëria e kësaj certifikatë mund të vërtetohet përmes faqes zyrtare www.wqrcert.com ose www.thewas.us. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në verifikimin e të dhënave bazua në numrin e certifikatës në ueb faqen www.wqrcert.com, konfirmohen të dhënat dhe origjinaliteti certifikatës. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që pajisja e ofertuar për pozicionin TV outdoor modeli LH460MDPWBC/EN, nuk përmbush specifikimet teknike sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit në disa elemente sikurse janë: Vandal proof grade structure (IK08), Environment rating IP 55, Backlight Life cycle 50.000 hours, Operating temperature -30 / + 45°C, Antiglare safety 4+3 tempered glass, Shoch sensor . Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në tenderin e dorëzuar, sipas listës së pajisjeve, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me produktin Samsung, modeli me shifrën H460MDPWBC/EN. Katalogu nuk ofron informacione për plotësimin e këtyre kërkesave të përmendura në pretendim, e po ashtu nuk gjenden as në web faqen zyrtare në internet <https://www.samsung.com/uk/business/smart-signage/outdoor-omd-w-series/lh460mdpwbce/>. Përderisa në lidhje me kërkesën për operim në temperaturë ku është kërkuar që të jetë minimum -30°C dhe maksimum 45 °C, ky produkt nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që sipas katalogut edhe web faqes, pajisja operon duke filluar nga temperatura minimale 0°C. Rrjedhimisht nuk plotësohen kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofertuar fare terminal hyrës dhe dalës por vetëm laure automatike dhe se prodhuesi VDS, me pajisjet e të cilit ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, nuk prodhon terminale. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se autoriteti kontraktues në njoftimin në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka specifikuar kërkesat për pozicionet 1 dhe 2, përkatësisht terminal hyrës dhe dalës. Po ashtu AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën 3 “OE duhet të dorëzojë katalogë apo broshura për produktet e ofertuar”. Si dhe dëshminë dokumentare 3 “Katalogu ose broshura.” Ndërsa, OE i rekomanduar për kontratë ka

dorëzuar katalogun për terminale. Në këtë katalog prezantohet produkti “Berta” i prodhuesit VDS. Në katalog është përshkruar barriera-laura. Mirëpo, në katalog nuk ka informacione se ky produkt ka funksionet tjera të terminalit sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit nga autoriteti kontraktues ashtu siç u cek më lartë. Për shembull nuk ka informacion për kërkesat: thermal bar-code printer equipped with presenter and cutter for tickets;, alpha numeric display with 4 rows of 20 characters;, contactless smart card reader for season users;, vandal resistant taster for initiation of bar-code ticket printing;, IP intercom; modular microprocessor controller. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në RRUOPP, përkatësisht neni 39.8, precizohet se në rastet kur është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara, duhet refuzuar tenderi. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar .

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “NAS Systems” Sh.p.k – Gjilan se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë D.P.T “Pro-Computers” është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofertuar Sensor për matjen e gjatësisë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën 5 “OE duhet të dorëzoj një liste të pajisjeve duke nënvizuar modelet e ofertuar.” Dhe për këtë kërkesë ka kërkuar dëshminë dokumentare – “Lista e pajisjeve duhet të jetë origjinal”. Ndërsa në listën e prezantuar të pajisjeve nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka të dhëna për pozicionin 3-Sensor për matjen e gjatësisë. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit teknik, vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti verifikojë dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet autorizimet dhe katalogët (e OE-së, të rekomanduar për kontratë), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues ashtu siç u cek më lartë, më saktësisht të vërtetojë se OE i rekomanduar për kontratë a i ka përmbush kërkesat e specifikimeve teknike dhe kërkesave tjerat të kërkuara sipas dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve

publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Gjilan
- 1x1 OE - "NAS Systems" Sh.p.k - Gjilan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.